



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2022:026303

Datë: 11.05.2023

Numri i dokumentit: 04270790

Rev.nr.143/22

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Shukri Sylejmani dhe Fejzullah Rexhepi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit: Z. H. nga D., të cilin e përfaqëson Mejdin Selmani avokat në D., sipas autorizimit kundër të paditurës: Komuna e Dragashit, të cilën e përfaqësojnë përfaqësuesit e autorizuar I. R. dhe B. H., sipas autorizimit, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1643/2017, të datë 01.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.05.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Pranohet revizioni i të paditurës: Komuna e Dragashit, Prishen aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1643/2017, i datës 01.11.2021 dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prizren - Dega në Dragash, C.nr.87/15 I datës 26.01.2016, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash, C.nr.87/15 të datës 26.01.2016, është vendosur: I. Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Z. H. nga D., dhe është detyruar e paditura Komuna e Dragashit, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit për rrënimin e objektit afaristë banesor dimensionin 11,80 x 9,40 m, i cili ka qenë i përbërë prej 2 lokaleve, në përdhese dhe hapësirës për banim në kat, si dhe 2 garazhet sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, të cilat kanë qenë të ndërtuara në ngastrën kadastrale nr...., e sipas listës poseduese nr. ... ZK – D., si pronarë t'ia paguaj kompensimin në të holla në shumë prej 46.033,68 €, me kamatë të cilën e

Ilogarisin bankat në Kosovë në mjetet e deponuara deri në një vit, duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. II. Detyrohet e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 5.141 €, në afat prej 15 dite, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës me aktgjykimin Ac.nr.1643/2017, të datës 01.11.2021, ka vendosur që të: Refuzohet si e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Dragashit, dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren - Dega në Dragash C.nr. 87/15 i datës 26.01.2016.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqitur revizion e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, të pranojë si të bazuar revizionin, t'i ndryshojë të dyja aktgjykimet më të ulëta dhe të refuzojë padinë ose ta pranojë revizionin dhe t'i anulojë të dy aktgjykimet në tërësi.

Përgjigje në revizion ka paraqitur paditësi, me të cilin e ka kontestuar revizionin e të paditurës, me propozim që të refuzohet revizioni në tërësi si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i të paditurës është i bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka parashtruar padi me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të kompensimit të dëmit për rrënimin e objektit afarist - banesor me dimensione 11,80 x 9,40 m, e që përbëhej nga dy lokale, në përdhesen dhe hapësirës për banim në kat, si dhe dy garazheve në sipërfaqe prej 70 m<sup>2</sup>, që kanë qenë të ndërtuara në ngastrën kadastrale nr. ... sipas fletës poseduese nr. ... ZK – D., si pronarë ti paguajnë kompensimin në shumë të hollave prej 46.033,68 €, me kamatë nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin C.nr.87/15 të datës 26.01.2016, duke vendosur më decidivisht, si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: paditësi ka poseduar shtëpi P+1 dhe 2 garazhe, ku sipërfaqet në kate janë shfrytëzuar për banim, ndërsa përdhesja për lokale. Fillimisht paluajtshmëria lëndore nga ana e të paditurit ka qenë e eksproprijuar me aktvendimin ...nr....., të datës 01.03.1988, e në emër të BVI-së, për banim të atëhershëm, mirëpo pasi që shfrytëzuesi i eksproprijimit në afatin 3 vjeçar, nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit, nuk ka kryer sipas natyrës së objektit punime konkrete, me aktvendimin ... nr....., të datës 02.03.1992, është anuluar aktvendimi i administratës së njëjtë ...nr..... të datës 01.03.1988. Shfrytëzuesi i eksproprijimit BVI-ja, për banim ka qenë e obliguar që paditësit sipas ujdisë së arritur në procesverbalin e datës 29.07.1988, dhe kontratës të datës 05.08.1988, të siguroj një banesë 2

dhomëshe më të vogël, me sipërfaqe 53,83 m<sup>2</sup>, në katin e ..., në lam ..., nga drejtimi verilindor dhe një lokal afarist në sipërfaqe prej 37,89 m<sup>2</sup>, në lam. ..., nr. lokalit ..., me tualet. Objekti i paditësit nga ana e BVI-së, për banim në D., është rrënuar më datë 11.10.1988, ndërsa paditësit nuk i është ofruar asnjë objekt. Më vonë paditësit sipas procesverbalit të datës 10.06.1992, ku është arritur edhe ujdia ndërmjet paditësit dhe të paditurit që paditësi në emër të dhënies të ngastrës kadastrale nr.... dhe .... në sipërfaqe të përgjithshme prej 6.77 ari, të cilët tani janë të pastër pa asnjë objekt dhe kulturë jep në shfrytëzim të përhershëm Kuvendit të Komunës G., për ndërtimin e objektit afarist- banesor me 30 banesa nga JU Programi, dhe si kundër vlerë të merr në emër të kompensimit dy banesa dy dhomëshe, një lokal në përdhese të ndërtesës së re të ngritur dhe lokacionin për vendosjen e objektit të përkohshëm sipërfaqja e garazhit për garazhimin e automjetit të udhëtarëve. Mirëpo edhe deri te realizimi i kësaj ujdie nuk ka ardhur. Prandaj për gjykatën e shkallës së parë ka qenë jo kontestuese që paditësit i është rrënuar shtëpia në të cilën ai ka banuar si dhe dy lokale në përdhese dhe dy garazhe, dhe rrënimi është bërë nga shfrytëzuesi i eksproprijimit BVI-ja, e atëherëshme e banimit të Komunës së D. dhe në emër të objekteve të rrënuara të paditësit nuk është bërë asnjë pagesë në drejtim të kompensimit. Prandaj, sipas të cekurave paditësi ka të drejtën në kompensim të dëmit, ndërsa e paditura të njëjtën t'ia kompensoj sipas parimeve të përgjithshme për kompensimin e dëmit në kuptimit nenit 154 paragrafi 3 të LMD-së, e sipas këtyre dispozitave rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, përkatësisht nuk është e detyrueshme që këtë të bëjë personi përgjegjës, gjykata do të përcaktoj që t'i paguhet te dëmtuarit shuma e caktuar në të holla në emër të kompensimit të dëmit, pasi që është evidente që paditësi ka pësuar dëm jo vetëm në drejtim të situatës së tij materiale por edhe banesore. Ky kompensim sipas vlerësimit të dy ekspertëve është në vlerë prej 46.033,68 €, e të cilën gjykata e shkallës së parë e ka pranuar në tërësi si objektive. Gjykata e shkallës së parë nuk ka pranuar kundërshtimin e të paditurës se nuk ka legjitimitet pasiv dhe në këtë drejtim ka gjetur se është i pabazuar kundërshtimi, e duke u bazuar në nenin 58 paragrafi 2 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore që ka qenë në fuqi në momentin e lindjes së raportit kontestues..

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 154 të LMD-së, lidhur me nenin 58 të Ligjit për Marrëdhëniet Banesore.. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenin 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, e paditura ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.1643/2017, të datës 01.11.2021, ka vendosur që ta refuzojë ankesën e të paditurës, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta vërtetojë.

Gjykata e shkallës së dytë, ka vlerësuar se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm. Aktgjykimi i goditur me ankesë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të LPK-së, nga neni 194 e lidhur me nenin 182 paragrafi 2 pika b), g), j), k) dhe m), në të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, e as ato në të cilat thirret ankesa nga neni 182 paragrafi 2 pika n) të LPK-së. Kjo për faktin se aktgjykimi nuk ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet, dispozitivi është i kuptueshëm dhe i qartë dhe nuk ka kontradiktor me vetveten dhe arsyet e dhëna në aktgjykim dhe në këtë drejtim gjykata e

shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare për një vendim të drejtë e të ligjshëm.

Gjykata Supreme e Kosovës, nuk mund të pranojë qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta si të drejtë dhe të ligjshëm, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe si pasojë gjendja faktike nuk është vërtetuar plotësisht dhe se për këtë arsye nuk ekzistojnë kushtet për ndryshimin e aktgjykimit të goditur, për të cilin shkak aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë është dashur të prishen.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimi se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, për shkak se dispozitivi është kundërthënës me vetveten dhe me arsyet e dhëna në të dhe i njëjti është në kundërshtim me nenin 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, është i bazuar, për faktin se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ka të meta të atilla, për shkak të cilave, nuk mund të ekzaminohet. I njëjti nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes dhe ato pak arsye të cilat janë dhënë nga gjykata e shkallës së parë, janë të paqarta, kontradiktore dhe pa mbështetje në provat dhe procesverbalet nga shkresat e lëndës. Nga arsyetimi i aktgjykimit nuk mund të kuptohet se cilat janë pretendimet e palëve lidhur me gjendjen faktike dhe cilat janë të gjeturat e gjykatës. Gjykata nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë faktet vendimtare dhe në çfarë mënyre janë vërtetuar faktet e tilla, për të arritur deri te përfundimi mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Në arsyetim të aktgjykimit ka përshkrim të pretendimeve të palëve dhe të përmbajtjes së provave materiale të administruara të theksuara si në arsyetimin e aktgjykimit, por nuk ka vlerësime se cilat fakte janë provuar me këto prova dhe rrjedhimisht se si e ka vlerësuar gjykata besueshmërinë e këtyre provave. Gjykata nuk iu ka referuar dispozitave materiale - juridike të cilat nuk i ka cituar as si përmbajtje, e nuk ka arsyetuar se si gjendja e fakteve të gjetura nga ana e gjykatës e kualifikuar në raport me normat materiale - juridike jep përfundimin mbi themelësinë e kërkesëpadisë. Përveç të cekurave gjykata e shkallës së parë nuk e ka shqyrtuar fare pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës, të cilin pretendim pala e paditur, e ka paraqitur gjatë shqyrtimit kryesorë pranë gjykatës së shkallës së parë, e cila ka qenë e detyruar të jep sqarime lidhur me këtë pretendim, qoftë nëse e refuzon apo aprovon pretendimin e tillë.

Për shkakun e njëjtë edhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje të dispozitave të LPK-së, nga neni 160 paragraf 4 dhe 5 të LPK-së, sepse gjykata e shkallës së dytë nuk ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore dhe nuk ka arsyetuar vendimin e saj sipas pretendimeve dhe bazave për të cilat edhe sipas detyrës zyrtare ekzaminohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim për të gjitha pretendimet ankimore duke i vlerësuar në pajtim me dispozitat ligjore, dhe gabimisht ka vlerësuar se pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Në këtë rast Gjykata Supreme e Kosovës, ka mjaftuar me shkeljet e theksuara më lartë dhe nuk është lidhur në pretendimet e paraqitura sipas revizionit, për aplikim të gabuar të së drejtës

materiale, me çka mbi bazën e shkeljeve të konstatuara aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë u dashtë që të prishen dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e shkallës së parë në rigjykim, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LPK-së, në atë mënyrë që të vlerësojë kushtet nga të cilat varet zhvillimi i procedurës. Pastaj gjykata do të ndërmer hapat tjerë procedural në drejtim të nxjerrjes dhe administrimit të provave rreth vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të caktoi shqyrtimin kryesorë dhe sipas propozimit të palëve, të nxjerr prova në drejtim të vërtetimit të faktet vendimtare të cilat kanë ndikim në mënyrën e vendosjes, duke e mos përjashtuar mundësin e marrës në shikim të shkresave të lëndës sipas vendimit ... nr....., të datës 01.03.1988, dhe ...nr. .... të datës 02.03.1992, pastaj përmes vërtetimit të drejtë të fakteve duke aplikuar dhe zbatuar dispozitat të së drejtës materiale të ligjit (ligjeve) të cilat kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të detyrimeve në mes palëve, të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj çështjen e parashkrimit të kërkesës së paditësit sipas kundërshtimeve të bërë nga e paditura, në mënyrë që të ketë mundësi që në mënyrë të drejtë dhe objektive të vlerësoj rrethanat e çështjes lëndore e pastaj të vendos në mënyrë meritore lidhur me kërkesëpadinë e paditësit dhe pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitojë shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga kjo gjykatë, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore siç përcaktohet me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 224 paragrafi 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.143/22, datë 05.05.2023

Kryetar i kolegjit  
Rrustem Thaqi